

E DIEL
26 Qershor
2016



e-mail: milosa2005@yahoo.com



"Harta e ferrit", Sandro Botiçeli

NGA BARDHYL DEMIRAJ*

Të duash të shfletosh botimin e dytë të Fjalor Enciklopedik Shqiptar (= FESH II, bl. I-III, Tiranë 2008/9) e për më tepër të konsultosh diçka në të që lidhet në një mënyrë a një tjetër me atë fushë ose ato fusha, në të cilat fiton bukën e gojës, duhet të jesh vërtet i regjur me vaj e me uthull në jetën e sotme intelektuale shqiptare, e kjo jo thjesht dhe vetëm falë dhuntive të karakterit profesional, por edhe, madje sidomos, të kesh e të zotërosh sa e siç duhet – thënë me lezet (!!) – jo më pak se tri palë mend në kokë: a) një palë me qëmtuar me qetësi ato të reja pozitive që sjell vërtet ky botim i dytë në përfaqje me botimin e tij të parë (FESH Tiranë 1985, 1246 + XVI f.); b) një palë me pikasur se çfarë mungon ende, përkatësisht çfarë mund a duhet të mungonte vërtet në të, duke i përcjellë këto "mungesa" e "teprica" si të tilla e me dashamirësi edhe të lexuesi sqimatar "Milosoa"-s; e së fundi, c) një

palë vetëm me luajtur mendsh, meqë edhe në këtë ribotim ase arnojë të dorës së dytë në plot tri vëllime e me plot 3061 faqe (+ Parathënje f. I-XXVI) përballlemi jo rrallë me maksimumin tipike intelektuale-shqiptare të kohës sonë: "Më rrove, të rrova – brisku i berberit është!"

Në këtë shkrim modest – me të cilin vështirë të bëjmë a të shtojmë dikur ndonjë koleg a mik më shumë, edhe pse jemi më se të ndërgjegjshëm për gjithë çka shkruajmë e kumtojmë – sigurisht që jemi rrekur t'i shtëmangemi sa dhe si kemi mundur pikërisht palës së fundit, si i vetmi opion që nuk i sjell dobi kujt e aq më pak shkruesit të këtyre radhëve. Për të vënë në lëvizje palën e parë mjafton gjithsesi të ballafaqojmë

dy botimet e derisotme të FESH-it me njëri-tjetrin, duke ruajtur gjithherë orientimin në konceptin e ri shkencor-intelektual ndaj trashëgimisë historike-kulturore – goftë kjo materiale ase shpirtërore – të botës shqiptare në gurrën dhe rrjedhën e gjallesës së saj në kohë e hapësirë. E sigurisht që edhe në këtë rast do të ishte mirë që sekush të zbresë vetë drejt e në tekstet e këtyre dy botimeve e të përqsasë po vetë përgjedhjen, tipin dhe mënyrën e kompilitimit të zërave të veçantë me kumtin enciklopedik përkatës, sepse, po që se u referohemi thjesht dhe vetëm parathënjeve të tyre, sigurisht që askush prej nesh nuk do ta ketë të vështirë t'i mbushë mendjen (vetëm ?) vetes që Enciklopedia

Shqiptare gjëllin ndërkohë në Kopshtin e Edenit po-Shqiptar, ku nuk piqen ende vetëm bananet dhe marakuja, "molla e ndaluese" jo-se-jo.

Asgjëmangut vijmë kështu natyrshëm në mbyllje të prologut tonë hyrës, duke iu referuar asaj pale tjetër mendsh që cekëm më lart (pika b), bash pikasjes së 'mungesave', përkatësisht 'tepricave' që na shfaqen me bollëk në njërin apo tjetrin botim e që në një mënyrë a një tjetër mund a duan marrë parasysh dikur në ribotimet e radhës së këtij fjalori, në varësi kjo të plotësimit të bordit redaksional të FESH-it. E për t'u bërë tash disi më konkretë, po shpejtojmë t'i kumtojmë lexuesit se fillimisht jemi fokusuar në

këtë shkrim kryesisht në emrat e atyre persona(litete)ve dhe figurave të historisë kombëtare që na shfaqen si të tillë e si zëra të veçantë në njërin apo tjetrin botim të FESH-it, në vijim me të mirat dhe të metat që bartin metoda dhe mënyra e përgjedhjes, përkatësisht ajo e pasqyrimin të tyre në këto botime, duke ilustruar më pas natyrshëm ndonjë dukuri pas gjase tejet negative që feks me kohë e sidomos ndërkohë në jetën kulturore të hapësirës kompakte shqipfolëse, bash në njërin qendër kryesor urbane të saj, Tiranën, e cila mëton jo kot dhe jo rastësisht rolin e epiqendrës së diskursit intelektual e shkencor-albanologjik.

→ Vijon në faqen 16

Redaktor: Ben Andoni; Grafika Artan Buca 239

Në këtë numër: Fridrih Niçe me Zarathustrën (vijim i sjellë nga Lluqa Qafoku); Bardhyl Demiraj; Intervistë me Niels Hav; Nasho Jorgaqi; Bahri Myftari; Reshida Çoba etj...

ANMIZA
A

Shqipëria duket se e ka luks krijimin e një Enciklopedie, e cila mbart shumë probleme, sipas autorit. Përmes kësaj analize të gjatë, që do të botohet në dy numra, keni një shtjellë kritike të punonjësit shkencor, lidhur me problematikën që shtjellon botimi i Enciklopedisë shqiptare të pak viteve më parë...

Damnatio memoriae vs. laudatio funebris, dy shfaqje të 'tranzicionit' intelektual në Enciklopedinë Shqiptare

NGA BARDHYL DEMIRAJ

(LMU/München)

1. Dy fjalë hyrëse

Vijon nga Faqja 1

Prashtu bëjmë fjalë këtu për dy dukuri që tingëllojnë në fakt si kundërtëse: *damnatio memoriae* (= 'dënimi' si *shpëlarje e kujtesës*) dhe *laudatio funebris* (= 'lëvdata' si *fjalë mortore*), por që nuk shkaktojnë thuasht aspak përplasje me njëra-tjetrën, sepse e para ka të bëjë kryesisht me shuarje/shpëlarje të (pa)vetëdijshme të kujtesës historike si masë dënimi dikur e pashkruar për shumë e shumë prurje në ose për botën e kulturës shqiptare, ndërsa e dyta ka përçjell katabultimin e tipit masovik qoftë edhe – madje sidomos!!! – për së gjalli të shumë e shumë persona(litete)ve drejt atij piedestali zulummadh që në rastin tonë konkret pritet normalisht të identifikojë në mos të simbolizojë thelbin e të qenit pjesë e trashëgimisë së vyer e të patundshme kulturore-historike të botës shqiptare në kohë dhe hapësirë. Për fat të keq dukuria e parë gjëllin në latencën e saj prej gjysmë së dytë të shek. XX, dhe ka rrokur atë trashëgimi kulturore të përfutur *sidomos* para shpalljes së pavarësisë të shtetit të parë shqiptar (28 nëntor 1912), ndërsa e dyta ka marrë revan bash në kohën tonë, që vjen me thënë pas përmbyesjes së regjimit diktatorial në Shqipëri, pra në një periudhë, kur, krahas rropatjeve për konsolidim të jetës demokratike në këtë vend dhe kapërcim të fazës së dhimbshme të 'tranzicionit' shoqëror, jeta intelektuale shqiptare përfjeton edhe realizimin e botimit të dytë të FESH-it (Tiranë 2008/9).

Parë nga këto dy perspektiva, është thuasht e vetëkuptueshme që botimi i parë i FESH-it (Tiranë 1985) nuk mund të merret për çdo rast si sinor orientues ose faktor përfaqësues, sidomos sa i përket 'dënimit' të pashkruar si *shpëlarje e kujtesës*, përkatësisht 'lëvdatës' së (para)shkruar si *fjalë mortore* për zëra të atyre persona(litete)ve që kanë ndërruar jetë pas vitit 1985, përkatësisht për sosh, të cilët kemi ende fatin t'i shohim, lexojmë e përfjetojmë sot e gjithë ditën për së gjalli mes nesh.

Së fundi lejohe mi të shtojmë edhe dy kufizime të karakterit metodik, që e bëjnë të vuajë natyrshëm këtë shkrim:

Shkruesi i këtyre radhëve – siç edhe pritët! – nuk zotëron aspak aftësinë dhe mundësinë të realizojë analiza inductive dhe deduktive ekzakte në të gjitha ato fusha që mbulon FESH II, e për të cilat kanë punuar (me aq përkushtim) 168 forca të kualifikuara, të shpërndara në plot 21 redaksi, të kryesuara prej një bordi redaksional të përgjithshëm me 47 specialistë sqimtarë, përkatësisht prej një këshilli botues të përkohorë me shtatë anëtarë e të organizuara prej Qendrës së Enciklopedisë Shqiptare me gjashtë redaktorë shkencorë sikurse *last but not least* – bash në vend të hudhrës! – me redaktor të përgjithshëm filologun tashmë në pension, prof. (dr. ?) Emil Lafen dora vetë. Andaj është më se e kuptueshme që për analiza të rastit jemi mjaftuar të përqendrohemi thjesht dhe vetëm në ato



Bardhyl Demiraj

Vallë mundet të bëhet kaq shpejt!?

Dikush mund të shtrojë tash me të drejtë pyetjen: Sa ishte e përgatitur vallë Enciklopedia Shqiptare, në mos vetë inteligenca shqiptare dhe shkencat albanologjike me rrjetin infrastrukturor përkatës për t'u përballur me këtë imperativ të kohës (?), ndërkohë që duhej të përballëshin edhe probleme të tjera jo pak thelbësore, siç ishin p.sh. a) rrëgjimi rrëqethës i statusit social të intelektualit shqiptar dhe përgjithësisht ai i punonjësit shkencor albanolog e për pasojë edhe b) largimi masiv i trurit ku të mundte dhe si të mundte prej dheut "ku na ka rënë koka" (çajupi).

fusha, ku e ndjejmë veten më se të sigurt, siç janë gjuhësia, letërsia, besimi dhe përgjithësisht kultura popullore;

Shkruesi i këtyre radhëve – siç edhe pritët! – nuk kishte gjithashtu në dispozicion kapacitetet njerëzore e teknike për të bërë krehjen dhe klasifikimin e nevojshëm të të gjithë materialit enciklopedik, të ngërthyer në të dyja botimet e FESH-it me gjithë-gjithë 4349 faqe (= I: 1246 + XVI + II: 3061 + XXVI), aq më tepër që i mungonte qoftë fjalësi ashtu edhe platforma e projektit të njerit apo tjetrit botim të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, e për të cilat nuk ka fituar ende informacion, nëse janë botuar dikur e gjëkund. Andaj për arsye thjesht praktike kemi kaluar në analizë deri diku të detajuar vetëm vëllimin e parë të botimit të dytë (Tiranë 2008: shkronjat A – Gj = 872

f.), i cili korrespondon me 355 faqet e para të botimit të parë të FESH-it (Tiranë 1985). Këmbëngulim fort në këtë kufizim të karakterit praktik-metodik, meqë nuk mëtojmë asesi që rezultatet e analizave tona të përcjellin vërtetësi absolute për gjithë materialin në shqyrtim, edhe pse jemi më se të bindur se shifrat, faktet dhe rezultatet që janë përfutur në analizat e kësaj pjese janë më se domethënëse për të gjithë materialin enciklopedik që përfshihet në të dyja botimet.

2. Të dhëna të përgjithshme

a) ... lidhur me FESH I (Tiranë 1985)

Një lexim sado i përciptë i parathënies, përpos një shfletimi po aq të përciptë të botimit të parë të FESH-it, mjafton për të mësuar shpejt se kemi të bëjmë me

një arritje aspak të vogël në kulturën dhe shkencën shqiptare në kohën, me kohën dhe për kohën, në të cilën u përfutua: me të mirat, të këqijat e jo më pak me ato të liga mizore që bartte vetiu ky botim si produkt intelektual i përfutur nën dhunën strukturore, përkatësisht i kufizuar brenda një korrike ideologjike që e kish paracaktuar dhe përcaktuar politika vrasare e sistemit në fuqi ndaj kulturës dhe kërkimit shkencor albanologjik. Gjithsesi, në rast se i anashkalojmë qoftë edhe përkohësisht (!!) këtë kufizim dhe rrekemi të shfletojmë e të lexojmë midis rreshtash, askush prej nesh nuk do ta ketë të vështirë të kuptojë e të bindet se ky fjalor për nga mënyra e konceptimit të së tërës, aparati metodik, por edhe realizimi faktik i zërave të veçantë nuk bën asesi ndonjë hap të madh prapa kundrejt një fjalori enciklopedik ase enciklopedie kombëtare të paktën në Europën e fundshekullit të 20-të. Për më tepër, të bien në sy – edhe pse jo gjithmonë vetëm për mirë (!!!) – përpjesëtimet organike brendapër-brenda materialit enciklopedik që sendërtan në rreth 5000 zëra një kuadër deri diku të kënaqshëm të trashëgimisë dhe gjallesës së botës shqiptare në kohë e hapësirë e në fusha të ndryshme të jetës së saj materiale e shpirtërore.

Së fundmi, lejohe mi të shtojmë – e kjo ka të bëjë drejtpërdrejt me objektin e këtij shkrimi – se edhe ata zëra enciklopedikë që janë parashikuar në këtë fjalor për personalitete dhe figura të historisë kombëtare shqiptare (aty rreth 700 në numër), është bërë përpjekje – sikurse gjithkund në botim enciklopedike moderne të kohës sonë – që të bëhet kujdes i veçantë sidomos me të gjallët, madje edhe me syresh që kanë ndërruar jetë rishtas, duke i pasqyruar ata me masën dhe kutin e nevojshëm, anipse të pashkruar të moralit qytetar-intelektual, në kuptimin që askush s'ka ndërmend sot për sot t'i mbyllë dikur dyert kujt që i meriton të hapura si të tilla, por *Alfa* dhe *Omega* si detyrim sublim dhe i patjetërsueshëm i një fjalori enciklopedik ase enciklopedie, qofshin këto edhe kombëtare, është më i përcjellë lexuesit të interesuar trashëgiminë e patundshme kulturore-historike, të sanksionuar njëherë e për-gjithmonë si të mirëqenë në atë mjedis shoqëror, në të cilin ai mëton të ketë a të gjejë rrënjët e veta, përkatësisht të jetë i dëshiruar për të mësuar e ditur shumë më shumë për to, duke fituar kështu po vetë të drejtën me pjesëmarrë në debate të ndryshme të nivelit intelektual në mjedisin në fjalë. Parë nga kjo perspektivë, siç do të kemi rast ta hetojmë



BOTIM

NGA FRIDRIH NIÇE

Vijon nga numri i shkruar

O shpirti im, të mësova të thuash “sot” si të thoshe: “dikur” ose “njerherë”, dhe duke vallëzuar shpenguar të lësh mbrapa shpine çdo këtu dhe atje

O shpirti im të shpëtova nga të gjithë ëndëjëjt, të pastrova nga pluhurat, nga merimangat, nga gjysmëhijet.

O shpirti im, unë të pastrova nga turpi i vogël dhe nga virtyti i strukur qosheve dhe të binda të dilje lakuriq në sytë e diellit

Me stuhinë që quhet “shpirt” u fryra shkulumet të detit tënd; përzura gjithë retë, mbyta vetë mbytësin që quhet “mekat”

O shpirti im, të dhashë të drejtën të thuash “jo” si stuhia dhe “po” si qielli bosh: memec, i shtangët qëndron si drita dhe kalon mes stuhish mohuese

O shpirti im, të riktheva lirinë mbi të krijuarën dhe mbi të pakrijuarën: e kush e njeh siç e njeh ti lakminë e së ardhmes?

O shpirti im, unë të mësova përcëimin që nuk punon si ténja (krimbi që ha drurin), domethënë përcëimin e madh, atë që dashuron aq shumë sa edhe përcmon

O shpirti im, të mësova të bindesh në mënyrë që të bindje edhe shkaqet e tua për t’u ngjitur deri atje ku je ti: siç e bind dielli detin të ngjitet tek ai, në lartësinë e tij.

O shpirti im, unë të hoqa gjithë bindjen, të çmësova të gjunjëzohesh, të thuash “zotëri”, unë të dhashë emrin e “atij që përlut nevojën” dhe emrin “fat”

O shpirti im, të vura emra të rinj, të dhashë lodra të larmishme, të quajta “fat”, “periferi të periferive”, “kordon umbilikal të kohës” dhe “kambanë të kaltër”

O shpirti im, mbretërisë tënde në tokë i dhashë të pijë gjithë urtësinë, gjithë verërat e reja madje edhe pijet e forta të urtësisë, të lashta aq sa s’ju kujtohet koha

O shpirti im, me çdo diell të ujta, me çdo

Vërtet, o shpirti im! Kush s’do të mbytej në lot duke parë buzëqeshjen tënde? Edhe ëndëjëjt qajnë me dënësë mbi mirësinë e pandalshme të buzëqeshjes tënde

PËR GULÇIN E MADH, PËR ASPIRATËN E MADHE

natë, me çdo heshtje e me çdo gulç: dhe ti u rrite si një hardhi.

O shpirti im, tani i rënduar, i stërpasur më rri përballë, gjifryrë me rrush të pjekur ngjyrë ari të errët:

E pjekur dhe zgërlaqur nga lumturia jote, në pritje sepse po vërshon dhe e turpëruar për pritjen tënde

O shpirti im, askund nuk ka një shpirt më dashurues, më të aftë apo më të pamatë! Ku tjetër mund të jenë dot fqinj e shkuara me të ardhmen?

O shpirti im, gjithçka të dhashë tani, dhe prej teje jam duarbosh- dhe tani! Tani buzëqeshur dhe plot melankoli më thua: Kush prej nesh duhet të falënderojë?


A nuk duhet që ai që jep të falënderojë që ai që merr ka marrë? A nuk është një nevojë të japësh? A nuk është të marrësh-të mëshirosh atë që jep?

O shpirti im, e kuptoj buzëqeshjen e melankolisë tënde: vetë tepria jote shtrin me pasion lypësi duart!

Plotësia jote zhbiron detet vlues dhe kërkon dhe prët; dëshira e plotësisë balafaqohet me qiellin buzëqeshës të syve të tu!

Vërtet, o shpirti im! Kush s’do të mbytej në lot duke parë buzëqeshjen tënde? Edhe ëndëjëjt qajnë me dënësë mbi mirësinë e pandalshme të buzëqeshjes tënde

Mirësia jote, mirësia jote e pandalshme është ajo që nuk do të ankohet dhe të qajë: megjithatë, buzëqeshja jote, o shpirti im, sa s’po shkrehet në lot dhe goja që të drid-



het sa s’po gulçon

A nuk është ankim çdo qarje? A nuk është akuzë çdo ankim? “Kështu flet ti me vete dhe prandaj o shpirti im, preferon të buzëqeshësh dhe të mos shfrysh dhimbjen tënde.

të shfrysh me një lumë lotësh gjithë dhimbjen tënde mbi plotësinë tënde dhe mbi tensionin e hardhisë pranë fermerit dhe thikës së tij!

Por nëqoftëse nuk do të qash, nuk do t’i derdhësh gjithë lotët e melankolisë tënde,

do të të duhet ta këndosh shpirtin tim!- Ja edhe unë po qesh duke të parashikuar këtë:

-të këndosh, me një këngë vigane, derisa të gjithë detet të heshtin për të dëgjuar dihatjen tënde,-

-derisa mbi detet gulçues dhe të heshtur të rreshqasë barka, mrekullia e artë, rreth ari të së cilës shkëlqejnë gjithë gjërat e miratë këqija dhe të çuditshme;-

-edhe shumë kafshë të mëdha e të vogla dhe gjithçkaka këmbë të lehta dhe të çuditshme, që të mund të vrapojnë nëpër shtigje ngjyrë vjollcë,-

-drejt mrekullisë së pruarar, barkës së lirë dhe zotërisë së saj; por ky është fermeri i hardhisë që pret me thikën prej diamanti,-

-çliruesin tënd të madh, shpirti im, atë pa emër- të cilit do t’ja gjejnë emrin vetëm këngët e së ardhmes! Dhe ja, fryma jote ka që tani aromën e këngës të së ardhmes— që tani digjesh dhe ëndërron, që tani pi i etur në të gjithë burimet e thella kumbues të pushimit, që tani melankolia jote pushon në bekimin e këngëve të ardhme!—

O shpirti im, të gjitha t’i dhashë tani, edhe gjënë time të fundit, dhe prej teje janë bosh tani duart e mia: të të urdhëroja të këndoje, kjo ishte gjëja ime e fundit!

Të të urdhëroja të këndoje-po tani fol, fol; kush nga ne të dy duhet të falënderojë? ose më mirë akoma: këndo, këndo shpirti im! Dhe më lër të të falënderoj!

**Kështu foli Zarathustra.
*Përktheu Lluka Qafoku
vijon**

→ Vijon nga faqja 21

ekzekutuar, të dënuar dhe të arratisur politikë qysh në vitet e para të atij regjimi, ashtu edhe ndonjë disident i dënuar/pushkatuar ndër kohë, e sidomos një tjetër ish-komunistësh e veprimtarësh dikur të devotshëm, të cilëve u erdhi radha sipas planit me u dënuar/pushkatuar nga regjimi; të tillë si: Beqir Balluku (1917-1975: f. 172v), Petrit Dume (1920-1975: f. 546) etj.

Hetim më të detajuar kërkon edhe situata për periudhën e parë të konsolidimit të shtetit të parë shqiptar 1912-1944 bashkë me atë të LANÇ-it (faza nr. 5), ku ndeshim një rritje me vetëm 43 zëra (= 40,5%) në inventarin e zërave të personave në FESH II (gjithsej 109) kundrejt atyre në FESH I (gjithsej 66). Fshirjet e bëra në FESH II për këtë periudhë janë minimale e mund të lidhen ose me ndonjë harrësë, lajthitje a mosnjohje të rastit, ose me ndonjë pavërtetësi të kumtuar në FESH I. Kështu p.sh. shkruasi i këtyre radhëve nuk është në gjendje të shpjegojë dot, përse në FESH II nuk na shfaqet më emri i dëshmores së LANÇ-it Ylberë Billibashi (1929-1944 – FESH 196), apo ai i raposdit Prendush Gega (1850-1938, Kabashi/Pukë – FESH I 307: raposd).

Në rast se mënjanojmë tani me vetëdijë periudhën e parë (faza nr. 1: deri më 1400 e.j.; FESH I me 17 zëra kundrejt FESH II me 28, d.m.th. me rritje 11 zëra = 39%), ku – me ndonjë përjashtim të rastit – përfshihen kryesisht individë, jeta dhe veprimtaria e të cilëve lidhet në një mënyrë a në tjetër me hapësirën shqipfolëse, rrallëherë edhe me origjinën e tyre ndoshta arbëneshë

Damnatio memoriae vs. laudatio funebris – dy shfaqje të ‘tranzicionit’ intelektual në Enciklopedinë Shqiptare

(p.sh.: <Dhimitri i Arbrit> [= Arbënit – BD]; FESH II 569: “Sundimtar i Principatës së Arbrit në v. 1208-1216), na mbetet të përqendrohemi tash në periudhën ndërmjet viteve 1400-1912 (= faza nr. 2: 1400-1700, nr. 3: 1700-1800 dhe nr. 4: 1800-1912) që ndërthen një hapësirë kohore jo më pak se pesë shekuj e që në të dyja botimet e FESH-it mbulohe sipas rastit me gjithsej 74 (FESH I: 24 + 8 + 42) përkatësisht 86 (FESH II: 31 + 8 + 47) zëra. Pra kemi të bëjmë në FESH II me një shtesë qoftë edhe fiktive prej gjithë-gjithë 12 zërash që mbulon një kuotë shtesë tejet modeste me rreth 14%. Fiktiviteti i kësaj shifre përmirësohet në rastin tonë lehtësisht me jo më shumë se dy zëra shtesë, pasi në FESH II është mënjanoar nga inventari i botimit të parë ndonjë zë “pa ndonjë vlerë reale ose veprimtari të spikatur” siç është p.sh. rasti i Frederik Engels-it (FESH I, f. 239). E të mohosh rolin që ka luajtur filozofia marksiste-leniniste me pinjolltë e saj në formimin shkollor-universitar dhe ideologjik për më shumë se katër dhjetëvjeçarë në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shek. XX, është një lloj sikur të duash të mbulos diellin me shoshë, t’i thuash derit dajë e sigurisht të vijosh të punosh me instinktin e vjetër enciklopedik shqiptar që mbolli dhe polli procesin *damnatio memoriae* (shih më poshtë).

3.2. Përfundime paraprake

Mënjanimi i vetëdijshëm i periudhës së parë (faza nr. 1) nga ana jonë i jep tash formë dhe kuptim atij ‘tipari dallues’ (ndaj FESH I) që kumton në parathënie bordi redaksional i FESH II, siç është “pasqyrimi i gjerë i personaliteteve e i figurave të historisë kombëtare.” (f. XVII) Ky tipar ravijëzon vërtet konturet e një befasimi marramendës, po qe se i përmbahemi rezultateve të analizës paraprake me të dhënat faktike të qëmtuara prej nesh, përkatësisht përqasjes së kuotave të regjistrimit për periudhën e dytë (fazat nr. 2, 3, 4), që mbulon një hapësirë kohore po aq marramendëse në më shumë se pesë shekuj (v. 1400-1912) me gjithë-gjithë 86 zëra kundrejt periudhës së fundit (fazave nr. 5, 6, 7 dhe 8) që rrudhet në më pak një shekull (v. 1912-2008), por që përfaqësohet me plot 628 zëra, ndër të cilët më shumë se një e treta, plot 224 në numër, parakupton “personalitete e figura të historisë kombëtare” që pas gjase e kanë përjetuar atë moment fatlum të kalojnë nëpër duar, madje edhe të lexojnë dhe urojnë vetveten me sytë e gojën e vet, bash kur doli nga shtypi botimi i dytë i FESH-it. Përkundrazi, krejt të parëndësishëm në numër duhen vështuar “disa persona pa ndonjë vlerë reale ose veprimtari të spikatur, por që ishin përfshirë për shkak të emërtesave të kohës.” (f. XVII), të cilët, edhe në rast se e kanë

përjetuar fizikisht dhe mendërisht këtë botim, nuk kanë pasur atë fat të mirë a të keq me lexuar a dëgjuar, se si e në ç’mënyrë do t’u ishte lakuar emri në këtë botim të dytë.

Shpresojmë të mos e bezdisim lexuesin, në rast se insistojmë të përsërisim që analiza jonë me të dhënat e mësipërme është e kufizuar thjesht dhe vetëm në bleun e parë të këtij botimi (FESH II: shkronjat A-GJ), sepse numri faktik i këtyre “personaliteteve dhe figurave të historisë kombëtare” që kanë pasur fatin të përjetojnë *live* këtë fat fatlum është padyshim disa herë më i madh e i shpërndarë gjithkund në të gjithë botimin. E ky përfundim ka të bëjë vetëm me një rëndësi të cështjet thelbësore që kemi shtuar për diskutim në këtë shkrim modest. Çështja e dytë përkon natyrshëm me përjetimin që përcollim në formë vëzhgimi më lart, bash me atë diskrepancë sa befasese aq edhe marramendëse në kuotat e zërave ndërmjet periudhës më pak se njëshekullore (v. 1912-2008: fazat nr. 5, 6, 7, 8), në të cilën kanë mbirë si kërpudhat pas shtu plot 628 zëra kundrejt periudhës paraprakës, më shumë se pesëshekullore (v. 1400-1912: fazat nr. 2, 3, 4), por aspak të pëlleshme, në të cilën është katandisur kaposhi një thellë me gjithë-gjithë 86 zëra.

***Titulli është i redaksisë
Vijon numrin e ardhshëm**